

## MENAXHIMI I RISKUT NË RASTE KATASTROFASH – SIGURIMI I PRONAVE NË KOSOVË

**Myhybije ZALLQI- ZHARA**<sup>1</sup>  
**Ibish MAZREKU**<sup>2</sup>

### ABSTRAKTI

Ky punim fokusohet në politikat e reja në menaxhimin e riskut të katastrofave, duke përshkruar metodat më efektive të menaxhimit të riskut të katastrofave dhe si mund të aplikohen ato në kushtet e një ekonomie të vogël në zhvillim si ekonomia e Kosovës. Analizimi i shkallës së sigurimeve në raste katastrofash natyrore dhe katastrofash tjera nga faktori njëri në Kosovë janë shtyllat kryesore të punimit.

Me gjithë ekspozimin e tyre serioz ndaj riskut të fatkeqësive të shkaktuara nga ndikimi i risqeve natyrore përfshirë tërmetet, përmytjet, zjarret, thatësira dhe shkarja e tokës, shpeshësia dhe shkalla e dëmit të të cilave ka gjasa të rritet si rezultat i ndryshimeve klimatike, menaxhimi i rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore është shumë i dobët në Kosovë dhe në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Sidomos në këto vende është realisht inekzistente mbulimi i pronave të pronarëve të shtëpive dhe bizneseve të vogla me sigurimin në rast fatkeqësish.

rënda. Termat “risk society” (risku i shoqërisë) ose edhe “fear society” (frika e shoqërisë), gjithmonë e më shumë përdoren që të reflektojnë tek njerëzit një perceptim të ngushtë për rritjen e ekspozimit të tyre ndaj risqeve madhore, siç janë ato të katastrofave.

Risqet e reja dhe të katastrofës janë aspektet më të prekshme të rritjes së niveleve të risqeve. Për disa vite me radhë, shumë shtete të OECD, janë përballur me rishfaqjen e risqeve, shkalla dhe frekuenca e të cilave do të ishte e vështirë të imagjinohej më parë, përfshirë këtu terrorizmin modern, sidomos ai i 11 shtatorit të vitin 2001, si dhe disa katastrofa natyrore me pasojat e tyre të

**Fjalët kyqe:** Menaxhimi i riskut, sigurime, risigurim, katastrofa, sigurimi i pronave

---

<sup>1</sup> **Msc. Myhybije Zallqi Zhara** myhybije.zallqi@unhz.eu  
Univerziteti „Haxhi Zeka,,Pejë, Departamenti Agrobiznesit.  
Tel. +38649 202 061

<sup>2</sup> **Ass. Prof. Dr.Ibish Mazreku** ibish.mazreku@unhz.eu  
Univerziteti, Haxhi Zeka, Pejë, Departamenti Financa dhe Kontabilitet  
Tel.+3774 5265 700

## ABSTRACT

New risks and disaster are the most vulnerable aspects of increasing levels of risk. For several years, many OECD countries are faced with the reappearance of risks, scale and frequency of which would be difficult to imagine before, including modern terrorism, especially that of 11 September 2001, and several natural disasters with their serious consequences. The terms "Risk Society" or the "Society fear", increasingly used to reflect a perception among people close to increasing their exposure to major risks, such as those disasters.

Despite their exposure to the risk of serious accidents caused by the impact of natural risks, including earthquakes, floods, fires, droughts and landslides, the frequency and extent of the damage which is likely to increase as a result of climate change, management the risk of natural disasters is very weak in Kosovo and in the region of Western Balkans. Especially in these countries is really nonexistent property coverage homeowners and small businesses by providing disaster.

This paper focuses on new policies on disaster risk management, describing the most effective methods of disaster risk management and how to apply them in terms of a small developing economy like Kosovo's economy. Analysis of the level of security in case of natural disasters and other catastrophes, one factor in Kosovo are the main pillars of the paper.

**Key words:** Risk management, insurance, reinsurance, catastrophe, property insurance

## HYRJE

Karastrofat natyrore dhe katastrofat e shkaktuara nga njeriu po vazhdojnë të godasin fort vende, rajone dhe popullata. Pasojat e tyre janë jashtëzakonisht të mëdha në shumë këndvështrime. Në botë, shpeshherë dhe në rajonin tonë, kane ndodhur historikisht ngjarje që kanë tronditur rëndë zhvillimin ekonomik e social, të cilat përveç origjinës natyrore shpeshherë ndodhin dhe për shkak të gabimeve njerëzore apo akteve të provokuara. Vetëm në vitin 2012 u regjistruan 900 katastrofa natyrore në të gjithë botën, të cilat kanë shkaktuar dëme me një vlerë rreth 160 miliardë dollarë amerikanë<sup>3</sup>. Që prej vitit 2006 nuk ka pasur thujtë asnjë vit me më pak se 900 katastrofa natyrore. Në vitet 1980, një vit me 500 katastrofa konsiderohej ende si vit i jashtëzakonshëm.

Vitet e fundit shpeshtimi i ngjarjeve me natyrë katastrofike dhe rritja e dëmeve të shkaktuara prej tyre, shihen si një kërcënim i madh për

---

<sup>3</sup> Munich Re (2012) "Annual Review of Natural Disasters", Munich Re, faqe 15

zhvillimin ekonomik, social dhe human në shumë vende të prekura ose që rrezikojnë të preken prej tyre. Ngjarjet katastrofike, janë konsideruar shkak edhe për prishjen e ekuilibrit të institucioneve demokratike apo të vetë sistemit, në disa raste.

Qëllimi kryesor në këtë punim hulumtues është të bëjë një studim të shkurtër mbi zhvillimin e programeve të reja të sigurimit të katastrofave, duke përshkruar edhe metodat më efektive të menaxhimit të riskut të katastrofave dhe si mund të aplikohen ato në kushtet e një ekonomie të vogël në zhvillim si ekonomia e Kosovës.

### **Kontributi shkencor-praktik i hulumtimi**

Rëndësia e këtij studimi mendoj që është e madhe sepse risku i katastrofave është një fushë e kërkimit shkencor që është trajtuar fare pak apo aspak në vendin tonë dhe sjellja e një këndvështrimi teorik mbi katastrofat dhe efektet e tyre, me fokus ekonominë në tranzicion dhe të vogla siç është Kosova mendoj se ka rëndësinë e duhur.

Rezultatet e këtij studimi mendoj që do të jenë një kontribut modest përsa i takon kësaj fushe të gjërë siç është menaxhimi i riskut veçanërisht në kategorinë e sigurimeve vullnetare ku përfshihet edhe sigurimi nga katastrofat natyrore dhe ngjarjet tjera natyrore dhe njerëzore.

### **NOCIONI DHE KLASIFIKIMI I KATASTROFAVE**

Nuk ka një përkufizim përfundimtar dhe gjerësisht të pranuar për katastrofat. Siç e përmendëm më sipër, ngjarje të ndryshme mund të konsiderohen katastrofike nga individët të cilët preken prej tyre.

Banks (2005) e përkufizon një katastrofë si "... një ngjarje natyrore ose e shkaktuar nga njeriu, me probabilitet të vogël, që krijon tronditje në kornizën ekzistuese sociale, ekonomike apo mjedisore, dhe që ka potencialin të shkaktojë humbje të rënda njerëzore dhe financiare"<sup>4</sup>.

Një nga kompanitë më të mëdha të risigurimeve, Munich Re, përdor konceptin në vijim në raportin e saj vjetor mbi katastrofat natyrore "nëse impakti i ngjarjes tejkalon mundësitë e zonës së prekur dhe kërkon ndërhyrje ndërajonale apo ndërkombëtare, atëherë një ngjarje e rëndë katastrofike ka ndodhur"<sup>5</sup>.

Një përkufizim që mund të përdorim në vijim (Lito et al. 2011) për katastrofat do të jetë: "Katastrofa është një ngjarje e befasishme

---

<sup>4</sup> Banks E. (2005), "Catastrophic Risk, Analysis and Management", Wiley fq. 5.

<sup>5</sup> Munich Re (2002) "Annual Review of Natural Disasters", Munich Re, fq. 15.

shkatërrimtare, e cila shkakton humbje të mëdha njerëzore, materiale dhe ambientale, të cilat tejkalojnë mundësinë e komunitetit të prekur t'a përballojë duke përdorur burimet e veta<sup>6</sup>.

Për qëllime studimi, por edhe duke ju referuar karakteristikave që paraqesin, katastrofat klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme. Klasifikimi kryesor mbi katastrofat bazohet te origjina e shkakut që provokon ndodhjen e tyre. Mbi këtë kriter, ndarja kryesore e katastrofave është ndërmjet katastrofave me prejardhje natyrore dhe atyre me prejardhje njerëzore.

Në literaturë përdoret edhe një një klasifikim i katastrofave sipas ndikimit të tyre. Sipas madhësisë së dëmeve që shkaktojnë dallohen: katastrofat me efekte të vogla (lokale), katastrofa me efekte të ndjeshme në një zonë të caktuar, si dhe mega-katastrofat.

## RISKU I KATASTROFAVE DHE ZHVILLIMI I MODELEVE PËR MENAXHIMIN E KËTIJ RISKU

Duke përcjellur trendet e zhvillimit të biznesit të sigurimeve në botë shohim që kjo industri është në fazën e ndryshimeve dhe adaptimeve me rrethanat e reja, të cilat janë krijuar si pasojë e ndryshimeve në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të cilat lidhen me këtë biznes<sup>7</sup>. Në trendin aktual shohim një avancim të dukshëm në projektet për menaxhimin e riskut veçanërisht atij të katastrofave.

Risku i pastër paraqet ato risqe ku ekziston mundësia vetëm për humbje, të cilat humbje vijnë nga ngjarjet që shkaktojnë dëme direkt apo pengojnë zhvillimin normal të aktivitetit të biznesit.<sup>8</sup>

Si lloje të rreziqeve të pastra mund të llogariten:

- **Katastrofa natyrore** - janë ngjarje të cilat shkaktojnë shkatërrimtare të menjëhershme, shkaktojnë dëmtime të mëdha, humbje ose shkatërrim total të pronës. Pra ky lloj i rrezikut mund të jetë fatal për bizneset apo qytetarët e një zone të tërë. Përveç dëmeve direktet në prona dhe jetë njerëzish, katastrofat mund edhe të bllokojnë zhvillimin e aktivitetit normal të biznesit, si dhe në rritjen ekonomike të tij.

---

<sup>6</sup> Lito et al (2011), "Manaxhimi i riskut të katastrofave", Qendra Shqiptare për Riskun – Konferenca III Ndërkombëtare proceedings, faqe 236

<sup>7</sup> Mazreku, Ibish (2007), "Menaxhmenti në kompanitë e sigurimeve me vështrim të veçantë roli i menaxheri", Prishtinë, fq. 47.

<sup>8</sup> Muça, Rejnald dhe Lito, Gerdi (2005) "Risqet me të cilat përballlet biznesi shqiptarë dhe menaxhimi i tyre", Tiranë

- **Ngjarjet natyrore ose njerëzore-** janë ngjarje me ndikim më të vogël se katastrofat, por që mund të jenë fatale për një biznes apo familje nëse nuk është i mbuluar me sigurim.

Si çdo lloj tjetër risku edhe risku i katastrofave mund të vlerësohet dhe modelohet për të dhënë një dimension të qartë të pasojave të tij. Sot ky proces është një prej elementëve më të rëndësishëm në industrinë e sigurimeve dhe risigurimeve, duke qenë se dëmet nga katastrofat zënë një pjesë të rëndësishme të dëmeve totale të paguara nga kjo industri. Procesi i modelimit të riskut të katastrofave është shpesh kompleks, kërkon të dhëna të shumta e të sakta dhe përdor teknika mjaft komplekse aktuariale.

Modelimi i riskut të katastrofave është njëherësh një temë e nxehtë e debatit shkencor në fushën e sigurimeve, të financës dhe të aktuaristikës. Madje mund të thuhet se modeli është shpesh rezultat i kombinimit të njohurive në më shumë se një disiplinë<sup>9</sup>. Zakonisht në këtë proces angazhohen specialistë nga fusha e financës, sigurimeve, aktuaristikës, inxhinierisë, kontabilitetit, shkencave gjeofizike, meteorologjisë, fizikës, etj.

Në vitet 2000 zhvillimi i industrisë së modeleve të riskut të katastrofave ishte i vrullshëm, ndërkohë që është shoqëruar edhe me njëfarë konfuzioni në tregje. Përveç disa kompanive kryesore që kanë ndërtuar programe për menaxhimin e riskut të katastrofave si dhe programeve open-source, filluan të krijoheshin modele vetjake (in-house) nga shumë kompani sigurimi të cilat ishin tepër specifike dhe të rezervuara për kompani të caktuara<sup>10</sup>.

Sot tendenca është drejt programeve open-source (pra me kod të lirë) që mund të përshtaten gjerësisht me kërkesat e përdoruesve dhe kompleksitetin e operacioneve të tyre financiare. Ekziston një shumëllojshmëri modelesh për modelimin e riskut të katastrofave. Modelet ngjajnë midis tyre, por nuk janë të njëjtë. Përgjithësisht të gjithë modelet kanë të njëjtat module dhe rezultatet i japin në formë të ngjashme. Ata vazhdojnë të dallojnë nga mënyra e ndërtimit dhe aplikimi i tyre. Llojet e katastrofave të modeluara përfshijnë kryesisht tërmetet, uraganet, përmytjet, stuhitë dimërore, tornadot, si dhe terrorizmin. Tregu kryesor vazhdon të jetë tregu i Amerikës së Veriut & Qendrore (SHBA, Kanada,

<sup>9</sup> Grossi P. dhe Kunreuther H. (2005) "Catastrophe modeling: a new approach to managing risk", Springer, fq. 43.

<sup>10</sup> Cannon T. (2003) "Vulnerability analysis, livelihoods and disaster components and variables of vulnerability: Modeling and analysis for disaster risk management", IBD/IDEA Program of Indicators for Risk Management, fq. 69.

zona e Karaibeve), ndonëse ka një ekspansion edhe në Evropë dhe vendet aziatike.

Disa nga problemet që shfaqin modelet e riskut të katastrofave sot (përveç faktit që janë shumë të shtrenjtë për tu blerë ose ndërtuar vetë) janë:


- Nuk janë standard; një model i përdorur për një lloj rrisht/zonë të caktuar nuk mund të përdoret për të tjera. Kështu për shembull, një model i rrishtit të stuhive të erës në Evropë ndryshon nga ai i tornadove në SHBA.
- Nuk janë fleksibile, kanë kosto relativisht të larta të ndryshimit apo azhurnimit,
- Nuk janë shumë transparente për mënyrën sesi ndërtohen dhe si paraqesin rezultatin (bëhet fjalë për modelet tregtare të krijuara nga kompani të specializuara dhe jo për modelet e krijuara nga vetë kompanitë e sigurimeve).

## **BALLKANI – INDUSTRIA E SIGURIMEVE DHE KATASROFAT**

Industria e sigurimeve në Ballkan ka filluar të zhvillohet kryesisht pas vitit 1990, kohë gjatë të cilës, në këto vende kishte rënë sistemi komunist dhe filloj të aplikohet një sistem i bazuar në ekonominë e tregut. Të dhënat e studiuara për këtë zonë (përfshijtur Greqinë që ka një historik më të hershëm të sigurimeve) tregojnë që shumica e vendeve ndodhen në një fazë të herët të zhvillimit të tregut të sigurimeve. Përfshijtur bën Sllovenia që ka një nivel më të avancuar të zhvillimit të këtij tregu. Kroacia, Rumania dhe Bullgaria gjithashtu kanë njëfarë progresi në këtë industri krahasuar me mesataren e rajonit, ndërkohë që vendet e tjera kanë nivel të ulët të zhvillimit të tregut të sigurimeve dhe risigurimeve<sup>11</sup>.

<sup>11</sup> UNISDR (2012) “Building resilience to disasters in the Western Balkans and Turkey”, Kombet e Bashkuara, fq. 77

Grafiku 2. Niveli i primeve dhe dëmëve në vendet e Ballkanit, 2011 (milionë euro)



Në grafikun 2 është prezantuar niveli i primeve të shkruara dhe dëmeve të paguara për të gjithë tregun e sigurimeve në 10 vende të Ballkanit. Karakteristika kryesore e evidentuar në mënyrë të menjëherëshme dhe që vihet re tek të gjithë këto vende është që niveli i dëmeve të paguara është përgjithësisht i ulët, më pak se gjysma e nivelit të primeve të shkruara (me përjashtim të Sllovenisë 61% dhe Rumanisë 55%). Kjo shpjegohet me nivelin ende të ulët të shërbimit nga kompanitë e sigurimit, mentalitetin dhe faktin që tregu dominohet nga sigurimet e detyrueshme të mjeteve motorike.


Situata përkeqësohet më tepër nëse studiojmë të njëjtin raport vetëm për pjesën e sigurimit të pronës nga zjarri dhe risqet natyrore (grafiku 3). Klasa e sigurimeve të pronës nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore zë rreth 17% të totalit të primeve dhe dëmet e paguara rreth 31.5% të totalit të dëmeve të paguara<sup>12</sup>. Kroacia (56%) dhe Sllovenia (47%) kanë nivelin më të lartë të dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara për këtë klasë sigurimi. Në Bullgari (31%) dhe Serbi (22%) primet e shkruara për këtë klasë zënë një pjesë të rëndësishme në totalin e primeve. Ndërsa në Serbi (17%), Kroaci (16%) dhe Maqedoni (16%) dëmet e paguara për këto lloj risqesh zënë peshën më të madhe ndaj totalit ndërmjet gjithë vendeve.

Nuk ka një uniformitet të raporteve brenda tregut të sigurimeve në vende të ndryshme. Përgjithësisht në vendet me zhvillim më të lartë ekonomik (Slloveni, Kroaci, Bullgari, Rumani) kemi dhe një pjesëmarrje më

<sup>12</sup>Lito G. (2013) “Katastrofat dhe industria e sigurimeve – problematika në tregjet ballkanike”. Revista Shqiptare Social-Ekonomike, Nr 2 (75) fq. 75-82.

të madhe të sigurimit të jetës dhe pronës. I gjithë tregu i sigurimit të pronës nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore në Ballkan (përfshirë Greqinë) është rreth 1.17 miliardë Euro në vit prime të paguara. Sa i përket Kosovës të dhënat për vitet 2010-2012 do i paraqesim në vazhdim të punimit.

Grafiku 3. Niveli i primeve dhe i dëmeve për sigurimin e pronës nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore në rajonin e Ballkanit, 2011



## DISKUTI MI DHE ANALIZA E REZULTATEVE MBI SIGURIMIN E PRONAVE NË KOSOVË NGA KATASTROFAT

Për të analizuar tregun e sigurimeve të pronave nga katastrofat natyrore dhe ngjarjet tjera nga faktori njeri në Kosovë dhe për të njohur se sa është shkalla e aplikimit të produkteve të sigurimit që lidhen me pronën, kemi shfrytëzuar të dhënat nga autoriteti mbikëqyrës që është BQK-ja dhe të dhënat nga kompanitë e sigurimeve të përfshira në studim e që janë gjithsej dhjetë (duke i analizuar 3 kompanitë e sigurimeve që ofrojnë produkte të sigurimit të jetës).

Nga hulumtimi i kryer kemi konstatuar se kompanitë e sigurimeve në Kosovë e ofrojnë produktin e sigurimit të katastrofave në mënyrë të ngjashme me produktet e tjera të sigurimeve. Në shumicën e rasteve nuk ka



polica të veçanta për ngjarjet katastrofike, por këto lloj risqesh janë të përfshira në policat e sigurimit ndaj risqeve të ngjarjeve natyrore, zjarrit, etj.

Sigurimi i katastrofave në pjesën më të madhe të tij përbëhet nga sigurimi i pronës në nivele të ndryshme (sigurimi i banesave, sigurimi i pronave të bizneseve etj). Llojet e tjera të sigurimeve (sigurimi i jetës, shëndetit, përgjegjësisë, etj) mbulojnë edhe ngjarje katastrofike, gjithsesi pjesa dërrmuese e primeve të paguara për mbulim nga ngjarje katastrofike i takojnë sigurimit të pronës. Pjesëmarrja e sigurimeve vullnetare ku përfshihet sigurimi i pronës në totalin e primeve të shitura të sigurimeve po e paraqesim në tabelën më poshtë.


Tabela 1. Primet e shkruara bruto, sigurimet jo-jetë

Aktiviteti	2011 (mln)	2012 (mln)	Ndryshimi ne %	Fjesëmarrja 2011	Fjesëmarrja 2012
Sigurime te Detyrueshme	47,4	50,7	7.1%	70,1%	72,7%
Sigurime Vullnetare	20,2	19,0	-5.7%	29,9%	27,3%
Gjithsej sigurime jo jetë	67,6	69,8	3,2%	100%	100%

Burimi: BQK (2013)

Nga tabela shihet se sigurimet e detyrueshme po vazhdojnë dominim e tyre krahas sigurimet vullnetare, duke sjellë rreth 72,7% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve. Këto të dhëna po i paraqesim grafikisht në vazhdim.

Grafiku 1. Portfolio e sigurimeve jo-jetë



Burimi: BQK (2013)

Gjatë vitit 2012, sigurimet vullnetare kapën shifrën rreth 19,0 milion euro ose 5,7% më pak në krahasim me vitin 2011. Rënia e sigurimeve vullnetare në krahasim me vitin 2011, njëherazi tregon edhe rënien e

pjesëmarrjes së këtyre produkteve në total portofolin e primeve të shkruara gjatë vitit 2012<sup>13</sup>.

Tabela 2. Sigurimet vullnetare dhe pjesëmarrja e sigurimit të pronës në këto sigurime

Përshkrimi	2011	2012	Ndryshimi ne %	Pjesëmarrja 2011	Pjesëmarrja 2012
Aksident dhe shendet	9,9	9,2	-7,1%	49,0%	48,1%
Sigurimet Motorrike	2,8	3,0	4,8%	14,1%	15,6%
Zjarr & Dëmtime ne prone	3,0	3,7	24,6%	14,6%	19,3%
Pergjegjesi te pergjithshme	2,0	1,1	44,2%	10,0%	5,9%
Kredi dhe Garancione	1,5	1,5	0,9%	7,6%	8,1%
Humbje Financiare	1,0	0,5	43,4%	4,7%	2,8%
Gjithsej	20,2	19,0	-5,7%	100,0%	100,0%

Burimi: BQK (2013)

Edhe pse nga një bazë shumë e ulët, është për tu vlerësuar si tregues i mirë rritja e primeve nga klasa e sigurimit të pronës ku në vitin 2012 shënuan rritje prej 24.6% në krahasim me vitin 2011. Nga gjithsej primet e shkruara të sigurimeve vullnetare, peshën më të lartë specifike e përbën grupi i klasëve të sigurimit “Aksident dhe shëndet” me 48,1%, pastaj sigurimet “Zjarr dhe dëmtime tjera në pronë” me 19,3%<sup>14</sup>.

## **PROBLEMET PËR MENAXHIMIN E RISKUR TË KATASTROFAVE NË INDUSTRIJËN E SIGURIMEVE NË KOSOVË**

Me gjithë ekspozimin e tyre serioz ndaj rrezikut të fatkeqësive të shkaktuara nga impakti i rreziqeve natyrore përfshirë tërmetet, përmytjet, zjarret në pyje, thatësira dhe shkarja e tokës, shpeshësia dhe shkalla e dëmit të cilave ka gjasa të rritet si rezultat i ndryshimeve klimatike, menaxhimi i rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore është shumë i dobët në Kosovë dhe në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Sidomos në këto vende është realisht inekzistente mbulimi i pronave të pronarëve të shtëpive dhe bizneseve të vogla me sigurim në rast fatkeqësish. Përveç vuajtjeve njerëzore dhe humbjeve në njerëz, katastrofat natyrore kanë një ndikim të

<sup>13</sup> BQK (2013); “Raporti vjetor 2012”, Prishtinë, Qershor, fq. 111.

<sup>14</sup> BQK (2014); “Raporti i stabilitetit financiar”, Prishtinë Janar, Nr. 04.

konsiderueshëm në performancën ekonomike dhe stabilitetin makro ekonomik të vendeve të prekura.

Në një vend të vogël si Kosova, me eksperiencë të shkurtë në ekonominë e tregut, sfida e parë për vlerësimin e riskut të katastrofave vjen prej zhvillimit të ulët të tregut të sigurimeve. Tregu i sigurimeve është i ri dhe shumica e kompanive private që operojnë në të nuk kanë më shumë se 10 - 14 vjet eksperiencë. Për më tepër industria e sigurimeve në Kosovë është e fokusuar në sigurimet e detyrueshme të përgjegjësishë së automjeteve dhe ka një shkallë të ulët në sigurimet vullnetare të pronave. Tregu është ende kaotik dhe nuk ka një prirje të qartë zhvillimi. Për shkak të këtij zhvillimi të kufizuar, ka pak ose aspak interes nga kompanitë e sigurimit për të zhvilluar ose blerë modele të menaxhimit të riskut të katastrofave, të cilat mund të jenë tepër të shtrenjtë për buxhetet e këtyre kompanive. Megjithëse ngjarje katastrofike si zjarret, termetet apo përmytjet janë të përfshira shpesh në policat e sigurimit të pronës që shiten në Kosovë, numri i policave të shitura është ende i kufizuar (dominojnë pronat tregtare të siguruara dhe jo banesat).

Siguruesit kanë gjetur si mënyrë më të thjeshtë e të përshtatshme të manaxhojnë këtë risk duke e transferuar riskun e katastrofave drejt risiguruesve nëpërmjet cedimit të këtyre risqeve në kontrata risigurimi. Futja në treg e kompanive të huaja, kryesisht sllovene dhe austriake, mund ta ndryshojë disi situatën në të ardhmen, gjithsesi për momentin nuk është në fokus të tregut të sigurimeve menaxhimi i riskut të katastrofave. Më së shumti është qeveria që mund të jetë e interesuar në manaxhimin e këtij lloji risku dhe zhvillimit të këtyre modeleve.

## PËRFUNDIM

Mund të përfundojmë se Kosova nuk konsiderohet si vend me risk të lartë ndaj katastrofave natyrore. Risqet kryesore natyrore në Kosovë janë zjarret në natyrë dhe përmytjet, në masë më të vogël stuhitë dhe ngricat (temperaturat e ulëta).

Tregu i sigurimeve në Kosovë nuk mundëson aktualisht përballimin e pasojave të riskut të katastrofave natyrore dhe njerëzore. Risku i katastrofave nuk është bërë objekt mbulimi prej këtij segmenti të tregut të sigurimeve deri më sot, dhe pothuaj e njëjta panoramë është edhe në disa vende të tjera të rajonit. Penetrimi i sigurimeve në treg është i ulët dhe për mbrojtjen nga katastrofat nuk ofrohen produkte të veçanta, por pjesërisht dhe vetëm në kuadër të mbulimit nga zjarri dhe risqet natyrore.

Vlerësojmë se duhet reagim i menjëhershëm në drejtim të përmirësimit të raportimit nga kompanitë e sigurimit me synim përfshirjen e

raportimit për katastrofat në paraqitjen e dëmeve të paguara nga këto kompani. Vlerësojmë se hartimi i një pasqyre përmbledhëse për dëmet e shkaktuara nga ngjarje katastrofike dhe përfshirja e saj brenda raportimit mujor për tregun e katastrofave do të ndihmonte mjaft në krijimin e një baze të dhënash që mund të përmirësojë ndjeshëm në të ardhmen vlerësimin dhe matjen e riskut të katastrofave.

Studimi mbi produktet e sigurimeve nga katastrofat me theks të veçantë në sigurimin e pronave në kompanitë e sigurimeve në Kosovë i realizuar në këtë punim është i pari i këtij lloji dhe rezultatet e këtij studimi mendoj që janë një kontribut modest përsa i takon kësaj fushe të gjërë siç është menaxhimi i riskut të katastrofave dhe mund ti vijjnë në ndihmë menaxherëve të këtyre kompanive. Rezultatet e këtij studimi janë kufizuar nisur nga mungesat e shumta në të dhënat mbi ecurinë e shitjes së primeve të sigurimeve të pronës në mënyrë kronologjike që nga paslufta e deri në vitin 2010. Mendojmë që rezultatet dhe argumentat e këtij studimi mund dhe duhet të jenë subjekt i debateve dhe studimeve të mëtejshme në këtë fushë.

## LITERATURA

- Banks E. (2005), “Catastrophic Risk, Analysis and Management”, Wiley.
- BQK (2014); “Raporti i stabilitetit financiar”, Prishtinë Janar, Nr. 04.
- BQK, “Raporti vjetor 2012”, Prishtinë 2013.
- Cannon T. (2003) “Vulnerability analysis, livelihoods and disaster components and variables of vulnerability: Modeling and analysis for disaster risk management”, IBD/IDEA Program of Indicators for Risk Management.
- Grossi P. dhe Kunreuther H. (2005) “Catastrophe modeling: a new approach to managing risk”, Springer.
- Lito et al (2011), “Menaxhimi i riskut të katastrofave”, Qendra Shqiptare për Riskun – Konferenca III Ndërkombëtare proceedings.
- Lito G. (2013) “Katastrofat dhe industria e sigurimeve – problematika në tregjet ballkanike”. Revista Shqiptare Social-Ekonomike, Nr 2 (75).
- Mazreku, Ibish (2007), “Menaxhmenti në kompanitë e sigurimeve me vështrim të veçantë roli i menaxheri”, Prishtinë.
- Muça, Rejnald dhe Lito, Gerdi (2005) “Risqet me të cilat përballet biznesi shqiptarë dhe menaxhimi i tyre”, Tiranë.
- Munich Re (2002) “Annual Review of Natural Disasters”, Munich Re.
- Munich Re (2012) “Annual Review of Natural Disasters”, Munich Re.
- UNISDR (2012) “Building resilience to disasters in the Western Balkans and Turkey”, Kombet e Bashkuara.